

STATUT

I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ISTED - Innovative Sustainable Territorial Economic Development” Sh.p.k.

Ky statut përpilohet nga :

- Z. Endri NOÇKA nënshtetas shqiptar i datëlindjes 10/01/1983, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga “Asim Zeneli” Nr.7 i pajisur me kartë identiteti me numër personal I30110049D.

Bazuar në Legjislacionin në fuqi, veçanërisht në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe sipas marrëveshjes së ortakut të vetëm dhe aktit të themelimit të hartuar prej tij, hartohet ky statut dhe në zbatim të Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

NENI 1

FORMA

Ortaku i vetëm krijon një Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri dhe në dispozitat e këtij Statuti.

NENI 2

EMRI I SHOQERISE

Emri i shoqërisë do të jetë “ISTED - Innovative Sustainable Territorial Economic Development” Sh.p.k.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Tiranë, Njësia 2, Rruga “Asim Zeneli”, Hyrja Nr.7, Kati 2, Zona kadastrale Nr.8160, Numri i Pasurisë Nr.6/363.

Shoqëria ka të drejtë që me vendim të Asamblesë së Ortakeve mund të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 5

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë është si vijon:

- Ofrimin e konsulencës, shërbimeve teknike dhe profesionale në fushën e Planifikimit të Territorit, si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në fushën e Planifikimit të Territorit.
- Ofrimin e konsulencës, shërbimeve teknike dhe profesionale në përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike, ofrimit të shërbimeve me një ndalesë dhe qeverisjes elektronike,
- Ofrimin e konsulencës, shërbimeve teknike dhe profesionale në studimin, analizën, hartimin e strategjive dhe implementim e politikave, në fushën e decentralizimit, dekoncentrimit, zhvillimit lokal, rajonal dhe kombëtar, zhvillimit ekonomik, zhvillimit të turizmit, zhvillimit të bujqësisë, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe historike, mbrojtja e mjedisit, politikë bërje dhe trajnime.
- Ofrimin e konsulencës, shërbimeve teknike dhe profesionale në fushat e menaxhimit dhe administrimit të biznesit, planeve të biznesit, studimeve të fizibilitetit, analiza, strategji, rregullore, auditime, etj.

Shoqëria mund të zhvillojë gjithashtu çdo aktivitet tjetër plotësues e ndihmës që rezulton i dobishëm dhe/ose i nevojshëm për përmbushjen e veprimtarisë së sajë.

Për të arritur objektin të saj, Shoqëria, me vendim te organit vendimmarrës mund te zotërojë, në mënyrë direkte apo indirekte, aksione apo pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

Shoqëria, me vendim te organit vendimmarrës, dhe me qellim arritjen e objektit të saj, mund të lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryeje çdo akt tjetër të nevojshëm. Për këtë qellim, Shoqëria mund te lidhe kontrata qiraje, shitblerje e hipotekimi të pasurive të paluajtshme, kontrata kredie, shërbimi dhe marrëveshje a kontrata te tjera te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë për behet në të holla me një vlere prej 100.000 lekë (njëqindmijë). Ky kapital është i ndare në 1 kuotë me vlerë 100.000 lekë.

Ky kapital zotërohet 100 përqind nga ortaku i vetëm.

NENI 7

KONTRIBUTET

Kontributi i përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti i takon Ortakeve të shoqërisë

NENI 8

FITIMI

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i mbetet në përdorim ortakut të vetëm.

NENI 9

TRANSFERIMI I PJESEVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjallëve dhe me trashëgimi.

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINSTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

NENI 10

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleje e Ortakeve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë që organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre.

NENI 11

DREJTIMI SHOQËRISË

Shoqëria ka këto organe drejtuese:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori.

Administratori i shoqërisë është Z. Endri NOÇKA për një periudhë 5 vjeçare.

NENI 12

KOMPETENCAT E ASAMBLEJË E ORTAKEVE

Asambleje e Ortakeve vendos për këto çështje :

- Emëron administratorin e shoqërisë.
- Emëron ekspert kontabël.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos për shpërndarjen e dividendit të shoqërisë.
- Bën ndryshime në statut.
- Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar.
- Në rast të shpërndarjes së shoqërisë cakton likuidatorin dhe e shkarkon atë kur përfundon

likuidimi.

-Vendimet e Asambleje e Ortakeve nënshkruhen prej orokëve.

NENI 13

ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet nga Z. Endri NOÇKA për një periudhe 5 vjeçare.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë emërohet nga Asambleje e Ortakeve, i cili përgjigjet për zbatimin e vendimeve të tyre

Administratori ka këto kompetenca:

- Të bëjë drejtimin e shoqërisë.
- Të përpilojë dhe nënshkruajë kontratat dhe aktet juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë.
- Të hapi llogari rrjedhëse bankare pranë bankave shqiptare ose të huaja.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretet.
- Të emërojë nëpunës të rangjeve të ndryshme për veprime të veçanta teknike ose për një kategori të caktuar veprimesh.

LIBRAT E LLOGARISE,BILANCI,FITIMI,SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 15

DOKUMENTACIONI

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël që kërkon legjislacioni në fuqi edhe këto libra:

- 1-Libri i ortakëve, në të cilin shënohet emri i plotë i Ortakëve dhe kuotat që ka secili në kapitalin e themelimit.
- 2-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Asambleje e Ortakeve.
- 3-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratorit.

NENI 16

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përfundimisht viti i pare financiar mund të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të përfundojë më 31 Dhjetor 2011. Llogarite vjetore, inventarët nga Administratori. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 17

ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit të shoqërisë që është përcaktuar në këtë statut, mund të vendoset nga Asambleje e Ortakeve

NENI 18

AKTIVITETI FINANCIAR

Në çdo mbyllje çdo viti financiar administratori bën inventarin dhe llogarinë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim.

Bilancit i bashkëngjiten:

- Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria.
- Një situacion mbi sigurimet e bëra nga shoqëria.

Raporti i administratoreve përfshin gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të eksperteve kontabël të autorizuar, të paktën një muaj para mbledhjes së asamblesë.

NENI 19

FONDIT REZERVË

Fitime neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, shoqërore, demet, amortizimet, etj. në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta financiare.

Përbërja, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezervë , përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi të veçantë caktohet nga Asambleje e Ortakeve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në përputhje me Nenin Nr.213 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet mënjane një shume me vlere 1/20 e cila destinohet për krijimin e një fondi “rezerve e domosdoshme”.

NENI 20

PRISHJA E SHOQËRISE

Shoqëria priset me kalimin e afatit të caktuar në statut dhe për arsye të parashikuara në ligj.

Shoqëria priset përpara afatit me vendim të Asambleje e Ortakeve

NENI 21

PAVLEFSHMËRIA

Rastet e pavlefshmërisë së shoqërisë ose të një akti që ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqërisë bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit “Për shoqëritë Tregtare”.

NENI 22

LIKUJDIMI

Kur shoqëria prishet ajo kalon në likuidim dhe në këtë rast emërtimit të shoqërisë i shtohet shënimi “Shoqëri në likuidim e sipër”. Shoqëria edhe gjatë procesit të likuidimit vazhdon si person juridik

Deri në përfundimin e procesit të likuidimit. Prishja e shoqërisë është me pasojë ndaj të trentëve vetëm pas publikimit të prishjes në regjistrin tregtar.

NENI 23

LIKUIDUESI

Për të përfunduar procesin e likuidimit, Asambleje e Ortakeve emëron një ose disa persona si likuidues të cilat përfaqësojnë shoqërinë. Likuiduesi përpilon bilancin financiar likuidon tek të tretët detyrimet e shoqërisë, shet aktivet e shoqërisë dhe ndan tepricat në dispozicion.

NENI 24

PËRFUNDIMI I PROCESIT TË LIKUJDIMI

Në përfundim të mbylljes së likuidimit, Asambleje e Ortakeve thirret që të vendosë për bilancin financiar përfundimtar, për aktin e rregullshmërisë, për administrimin e tij nga ana e likuiduesit dhe për heqjen e mandatit të likuiduesit, si dhe për tu evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentet e mësipërme miratohen nga Asambleje e Ortakeve.

NENI 25

PASURITË QË JANË VENË NË DISPOZICION DHE FITIMET PAS LIKUIDIMIT

Kur shoqëria likuidohet, pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi u kthehen pronarëve.

Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë dhe fondet fillestare ndahen ndërmjet ortakeve në përpjesëtim me kuotat e vëna pasi të jenë likuiduar kreditoret.

NENI 26

PROBLEMATIKAT

Shoqëria ka të drejtë të punësojë punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj. Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe rregullave të vëna në kontratën e veçantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit e punonjësit. Të gjitha problemet që do të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj shoqërie do të zgjidhen sipas rregullave të përcaktuar në statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen në mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 27

VULLNETI

Ky statut firmoset me vullnetin e lire nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

ORTAKU I VETËM

Endri NOÇKA

ENDRI NOÇKA



Datë: 11/12/2019

11/12/2019